



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
SHËRBIMI I KONTROLLIT TË BRËNDSHËM

REZULTATET E PUNËS SË
SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM
PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2014

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2014, në zbatim dhe përmbushje të angazhimeve të ndërmarra nga Ministria e Punëve të Brendshme, të reflektuara në Planin Vjetor të Punës së Shërbimit, si dhe objektit të veprimtarisë së tij, ka arritur këto rezultate konkrete:

Reformimi ligjor:

Projektligji i ri i Shërbimit, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave në mbledhjen e datës 30.04.2014, është shqyrtuar nen për nen nga Komisioni i Ligjeve, Komisioni miratuar në tërësi nga ky komision dhe aktualisht po shqyrtohet nga Komisioni i Sigurisë, i cili ka bërë miratimin në parim të tij.

Përmirësimi i trajtimit financiar të personelit të shërbimit:

U hartua dhe u miratua **V.K.M Nr. 244, datë 30.04.2014** për “Disa ndryshime në vendimin e K.SH. nr. 718, datë 23.06.2009, për pagat e punonjësve hetues, inspektues dhe të shërbimeve mbështetëse të SHKB-së”, në MPB, me një rritje të konsiderueshme të pagave më të ulëta.

Riorganizimi strukturor i shërbimit:

U hartua dhe u miratua Urdhri i Ministrit të Brendshëm, **Nr. 84, datë 25.03.2014** “Mbi miratimin e Strukturës dhe organikës së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ndryshimet strukturore dhe implementimi i tyre janë në funksion të forcimit dhe rritjes së cilësisë së hetimit administrativ dhe atij penal.

Transparenca dhe rritja e cilësisë së shërbimit ndaj publikut:

Masat e marra:

- Krijimi i Sektorit të Inspektimit të Ankesave, sipas strukturës së re të Shërbimit,
- Hartimi dhe miratimi i Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 1126, datë 23.05.2014 për “Rregullat mbi procedurat e Trajtimit dhe Inspektimit të Ankesave”,
- Rivendosja në punë e linjës jeshile **0800 90 90**, dhe instalimi i aparaturës regjistruese të thirrjeve telefonike 24 orë në 24,



- Krijimi i faqes së internetit të shërbimit me një informacion të detajuar mbi të gjitha portat e mundshme të komunikimit të publikut me shërbimin, si dhe pasqyrimin e aktiviteteve të Shërbimit,
- Prodhimi e shpërndarja e rreth 150 posterave për linjën jeshile,
- Vendorsja e kutive postare, për marrjen e ankesave/informacioneve të publikut.

Rezultatet konkrete:

- **105 ankesa** për periudhën **Janar – Mars 2014**
- **220 ankesa** për periudhën **Prill – Qershor 2014**
- **325 ankesa** gjithsej për periudhën **Janar – Qershor 2014**

Trendi rritës tregon për një rritje të besimit të publikut ndaj strukturave të shërbimit.

Trajtimi i ankesave nga strukturat e hetimit dhe inspektimit:

- Në **29** raste është sugjeruar fillimi i ecurisë disiplinore nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit,
- Në **10** raste është bërë referimi penal pranë organit të Prokurorisë,
- Vazhdon trajtimi i ankesave të tjera.

Përpjekje për të rritur cilësinë e hetimit dhe shkallën e zbulueshmërisë së veprimtarisë së kundërligjshme të kryer nga punonjës të veçantë të Policisë së Shtetit:

Nëpërmjet veprimtarisë informative, inspektuese, administrative dhe hetimit paraprak të gërshetuar me përdorimin e teknikave dhe metodave speciale të hetimit, gjatë këtij 6-mujori shërbimi i ka vlerësuar drejt të gjitha informacionet ndaj punonjësve të policisë, pavarësisht nga grada dhe funksioni dhe ka referuar një numër të konsiderueshëm kallzimesh penale për punonjës të policisë që dyshohet se kanë kryer elementë të veprës penale.

Janar – Qershor 2014, pranë organit të Prokurorisë, janë dërguar:

- **124** kallzime penale, kundrejt **54** kallzime penale për të njejtën periudhë të vitit të kaluar, pra **2.3** herë më shumë numër kallzimesh;
- **158** punonjës policie të kallëzuar, kundrejt **56** punonjës policie të kallëzuar për të njejtën periudhë të vitit të kaluar, pra **2.8** herë më shumë numër punonjësish.

Sipas niveleve të punonjësve të policisë të kallëzuar:

- **3** punonjës policie niveli i mesëm drejtues, kundrejt **1** punonjës i nivelit të mesëm drejtues për të njejtën periudhë të vitit të kaluar, pra një rritje **3** herë më shumë.
- **45** punonjës policie niveli i parë drejtues, kundrejt **17** punonjës policie të nivelit të parë drejtues për të njejtën periudhë të vitit të kaluar, pra **2.6** herë më shumë.
- **99** punonjës policie niveli zbatues, kundrejt **35** punonjës policie të nivelit zbatues për të njejtën periudhë të vitit të kaluar, pra **2.8** herë më shumë.
- **11** punonjës policie civile, kundrejt **3** punonjës policie civile për të njejtën periudhë të vitit të kaluar, pra **3.7** herë më shumë.


Ndaluar/Arrestuar në flagrancë **34** persona, kundrejt **15** persona për të njejtën periudhë të vitit të kaluar, pra **2.3** herë më shumë.



Gjithashtu është rritur niveli i zbulueshmërisë së **rasteve korruptive** ku:

- **85** kallëzime penale për raste korruptive, kundrejt **33** kallëzimeve penale për raste korruptive për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, pra **2.3** herë më shumë.
- **118** punonjës policie të kallëzuar për raste korruptive, kundrejt **40** punonjës policie të kallëzuar për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, pra **2.9** herë më shumë.

Grafiku krahasues për numrin e kallëzimeve penale dhe punonjësve të policisë së kallëzuar për rastet korruptive



Përpjekje për forcimin e strukturës së inspektimit, në funksion të hetimit administrative dhe inspektimit të ankesave:

Gjatë kësaj periudhe, strukturat e inspektimit kanë zhvilluar **20** inspektime, nga të cilat: **3** inspektime të planifikuara, **9** inspektime jashtë radhe, **6** inspektime për trajtim ankesash, **1** inspektim studimor dhe **1** inspektim në bashkëpunim me Inspektimin e Përgjithshëm të Ministrit, nga **7** inspektime: **6** të planifikuara dhe **1** inspektim jashtë radhe, të zhvilluar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Inspektimi e ka zgjeruar fushën e kontrollit të strukturave policore, duke përfshirë edhe ato të infranstrukturës ligjore, menaxhimit strukturor, funksional, organizativ, të burimeve njerëzore dhe logjistike e deri tek lidershipi, etika, sjellja individuale dhe kolektive e policisë, tematika këto të pa trajtuara më parë. Prandaj forcimi dhe rritja e cilësisë së inspektimit nuk qëndron tek numri i inspektimeve të kryera, më shumë apo më pak, por tek tematika për të cilën kryhet inspektimi dhe të cilësia e gjetjeve/konkluzioneve dhe rekomandimeve që ju jepen strukturave objekt inspektimi.



Kjo arritje pasqyrohet në këto rezultate konkrete krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013, ku nuk janë dhënë asnjë rekomandimet për fillimin e ecurisë disiplinore apo hetimit penal për punonjës policie të strukturave objekt inspektimi.

Gjatë kësaj periudhe **Janar – Qershor 2014**, është:

- sugjeruar fillimi i ecurisë disiplinore për **93** punonjës policie,
- sugjeruar fillimi i hetimit penal për **6** punonjës policie
- sugjeruar rivlerësimi i procedurave të pranimit, emërimit, ripranimit dhe qëndrimit në punë për **135** punonjës policie

Nga inspektimet e kryera si më poshtë vijon:

- **2 Inspektime** me objekt: “Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë dhe Berat”.
- **1 Inspektim** me objekt: “Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, Tiranë”.
- **4 Inspektime** në Drejtorinë e Policisë së Qarkut, Shkodër, Vlorë, Berat e Kukës me objekt: “Inspektim i strukturave të Personelit”.
- **1 Inspektim** në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe DPQ, Tiranë me objekt: “Mbi vlerësimin e procedurave për emërimin e punonjësve në Drejtorinë e Policisë Shkencore, pranë DPPSH dhe Sektori i Policisë Shkencore në DPQ, Tiranë.
- **1 Inspektim** në Drejtorinë e Policisë së Qarkut, Korçë me objekt: “Inspektim i menaxhimit të karburantit”.
- **1 Inspektim** në Qendrën e Formimit Policor me objekt “Mbi disa shkelje të evidentura për vijimin e studimeve part-time në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari”.
- **1 Inspektim** në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Gjirokastrë, Vlorë me objekt “Mbi inspektimin në lidhje me kultivimin, trafikimin, prodhimin e shitjen e lëndëve narkotike për periudhën janar- shtator 2013, në Qarkun e Gjirokastrës dhe rrethet Sarandë e Delvinë”.
- **1 Inspektim** me objekt “Vlerësimi i kryerjes së procedurave për disa urdhëra-shpenzime të kryera gjatë vitit 2013 në Komisariati i Policisë Ndërhyrja e Shpejtë, Tiranë”.
- **6 Inspektime** për shqyrtimin e ankesave të shtetasve, respektivisht: Bujar Velçani, Agim Harizi, Dritan Gjokolaj, Bardhi Koçi, Genci Zholi, Florian Beqaraj.
- **1 Inspektim studimor** në Stacionin e Policisë, Fushë Krujë, me autorizim të Ministrit të Punëve të Brendshme.
- **1 Inspektim** në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektimit të Ministrit me Urdhër të MPB me objekt: “Inspektim i gadishmërisë së strukturave policore në të gjithë DPQ-të”.

